



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3205/ 6 prot

Datë 21.01.2026

V E N D I M
Nr. 113/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Gentian Sadiku*” PF, si dhe lënien të skualifikuar operatorët ekonomik “*Melika Group*” SHPK dhe “*Amel – E.Z*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-65818-10-20-2025, me objekt “*Blerje materiale të buta dhe veshmbathje*” për *Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje*” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë)0 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Adresë: Rruga “Rreshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Gentian Sadiku*” PF me NIPT L42314005A, me adresë: Rruga “At Zef Pllumbi”, Pallati Nr. 16 Devi 2001 Pasuri Nr 39/118-n10 Zona Kadastrale 2679 vol 31, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*”

publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtar, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65818-10-20-2025, me objekt “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë)0 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 31.10.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 05.11.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “Melika Group” SHPK	2.155.305	lekë	skualifikuar
2- “Gentian Sadiku” PF	2.374.941	lekë	skualifikuar
3- “Amel – E.Z” SHPK	2.603.800	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 05.11.2025 operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, pasi në Çertifikatën OEKO-TEX standarti 100 kategoria II, shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin nr. rep. 1403 dt. 05.02.2025, konstatohet se kompania prodhuese e lëndës së parë “Akrida Tekstil” ka autorizuar subjektin “Blerina Sadiku” për të ofruar produktet e e saja dhe të përdorë çertifikatën OEKO-TEX, çertifikatën ISO 9001:20215 në prokurimet publike. Nga sa më sipër rezulton subjekti “GENTIAN SADIKU” nuk është i autorizuar për të ofruar produktet, të përdorë çertifikatën OEKO-TEX dhe çertifikatën ISO 9001:20215 të shoqërisë “Akrida Tekstil”.

Për më tepër, shoqëria pjesëmarrëse në procedurë “GENTIAN SADIKU” p.f me NUIS L42314005A ka deklaruar si prodhues shoqërinë “Blerina Sadiku” P.Fizik, si dhe ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kjo shoqëri. Referuar autorizimit të prodhuesit të paraqitur rezulton se shoqëria “Blerina Sadiku” P.Fizik ka autorizuar kompaninë Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS, L42314005A dhe adresë në Tiranë, që:

- të dorëzojë ofertë në emër timin,
- të negociojë, dhe
- të nënshkruajë kontratën në rast fitimi,

për tenderin me numër reference REF-65818-10-20-2025, i cili do të zhvillohet më datë 31.10.2025, ora 11:00, pranë AK: Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, me objekt: “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje për Drejtorinë e Spitalit ‘Ihsan Çabej’ Lushnje”.

Referuar këtij autorizimi rezulton se shoqëria “Blerina Sadiku” PF ka caktuar shoqërinë “Gentian Sadiku” PF si përfaqësues i saj në këtë procedurë prokurimi për të dorëzuar ofertë dhe nënshkruar kontratën në rast fitimi të procedurës së cituar të prokurimit në emër të saj, por jo të ofrojë apo shesë në emër të tij produktet e shoqërisë “Blerina Sadiku” PF në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim deklarimi nga OE i origjinës së mallit nuk është i vlefshëm. Nga sa më lart OE “Gentian Sadiku” PF nuk plotëson pikën 2.3.2 të KVK pasi nuk vërteton origjinën e mallit (prodhuesin), për produktet që ofron.

Si rrjedhim OE s`kualifikohet.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 06.11.2025 është Publikuar Njoftim Anullimi i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 09.11.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/6060 dhe me nr. 3205/2025 prot, datë 10.11.2025, e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65818-10-20-2025, me objekt “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF, si dhe lënien të skualifikuar operatorët ekonomik “Melika Group” SHPK dhe “Amel – E.Z” SHPK me pretendimet si vijon:.

Operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF me NUIS L42314005A, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë: - Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, pasi në certifikatën OEKO-TEX standarti 100 kategoria II, shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin nr. Rep. 1403 dt. 05.02.2025, konstatohet se kompania prodhuese e lëndës së parë “Akrida Tekstil” ka autorizuar subjektin “Blerina Sadiku” për të ofruar produktet e e saja dhe të përdorë “certifikatën” OEKO-TEX, “certifikatën ISO 9001:20215 në prokurimet publike. Nga sa më sipër rezulton subjekti “Gentian Sadiku” nuk është i autorizuar për të ofruar produktet, të përdorë “certifikatën OEKO-TEX dhe certifikatën ISO 9001:20215 të shoqërisë “Akrida Tekstil”.

Për më tepër, shoqëria pjesëmarrëse në procedurë “Gentian Sadiku” PF me NUIS L42314005A ka deklaruar si prodhues shoqërinë “Blerina Sadiku” P.Fizik, si dhe ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kjo shoqëri.

Referuar autorizimit të prodhuesit të paraqitur rezulton se shoqëria “Blerina Sadiku” P.Fizik ka autorizuar kompaninë Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS, L42314005A dhe adresë në Tiranë, që:

Të dorëzojë ofertë në emër timin,

Të negociojë, dhe

Të nënshkruajë kontratën në rast fitimi, për tenderin me numër reference REF-65818-10-20-2025, i cili do të zhvillohet më datë 31.10.2025, ora 11:00, pranë AK: Operatorit të Blerjeve të përqendruara, me objekt: “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje për drejtorinë e Spitalit I’hsan Cabej Lushnje”.

Referuar këtij autorizimi rezulton se shoqëria “Blerina Sadikuë PF ka caktuar shoqërinë “Gentian Sadiku” PF si përfaqësues i saj në këtë procedurë prokurimi për të dorëzuar ofertë

dhe nëshkruar kontratën në rast fitimi të procedurës së cituar të prokurimit në emër të saj, por jo të ofrojë apo shesë në emër të tij produktet e shoqërisë “Blerina Sadiku” PF në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim deklarimi nga OE i origjinës së mallit nuk është i vlefshëm. Nga sa më lart OE “Gentian Sadiku” PF nuk plotëson pikën 2.3.2 të KVK pasi nuk vërteton origjinën e mallit (prodhuesin), për produktet që ofron. Si rrjedhim OE s’kualifikohet.

Operatori jone ekonomik vëren që dy kompanite e tjera pjesëmarrëse (Melika Group dhe Amel-E.Z Shpk) nuk kanë paraqitur: Certifikatën OEKO-TEX, standarti 100, kategoria II (Melika Group SHPK) Kategoria I (Amel-E.Z SHPK).

Persa i perket dokumentacionit të kompanisë sone, Gentian Sadiku P.Fizik, vërejmë që KVO nuk ka vlerësuar në mënyrë të rregullt dokumentacionin e paraqitur në SPE. Konkretisht, KVO pretendon që OE jone nuk ka përmbushur 2.3.6 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, në të cilën kerkohet paraqitja e certifikatës OEKO-TEX, standarti 100, kategoria I dhe II, për të cilën KVO shprehet se është paraqitur autorizimi nga kompania e huaj “Akrida Tekstil” vetëm për OE “Blerina Sadiku” P.Fizik për të ofruar produktet e saja ndërkohë, nëse do të vërehet me kujdes, në SPE, kompania jone ka paraqitur dokumentacionin me emertimin: “Autorizim Akrida Tekstil Gentian OEKO-tex”, në të cilën shprehimisht thuhet se kompania AKRIDA TEKSTIL autorizon kompaninë “Gentian Sadiku” P.Fizik me nipt: L42314005A për të ofruar produktet tona dhe për të përdorur certifikatën OEKO-TEX, Certifikatën ISO 9001:2015 në procedurat e prokurimit publik. Si përfundim, kompania jone “Gentian Sadiku” P.Fizik plotëson pikën 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik në DT dhe pretendimi i KVO nuk qëndron.

Për sa i perket arsyetimit tjetër të KVO, në lidhje me autorizimin që kompania “Blerina Sadiku” ka leshuar në emër dhe për llogari të kompanisë sone, ngarkuar në SPE me emertimin Autorizim prodhuesi Blerina-OBP-Sp Lushnje, në të cilin thuhet shprehimisht: “Unë, Blerina Sadiku P.Fizik, me NUIS: K97730102T, me objekt aktiviteti: “Projektim, prodhim dhe tregtim konfeksionesh të ndryshme. Import-Export, tregtim veshmbathjesh dhe materialesh të buta sipas porosit të klientëve për qëllime teknike, profesionale, sportive, pune, sanitare-mjekësore, kohë të lirë, shkollë, ushtarake, policore, zjarrfikëse, mbrojtëse dhe siguri në punë, etj.ë, me anë të këtij autorizimi, autorizoj kompaninë Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS: L42314005A dhe adresë në Tiranë, që:

Të dorëzojë ofertë në emër timin,

Të negociojë, dhe

Të nënshkruajë kontratën në rast fitimi, për tenderin me numër reference REF-65818-10-20-2025, i cili do të zhvillohet më datë 31.10.2025, ora 11:00, pranë AK: Operatorit të Blerjeve të përqendruara, me objekt: “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje për drejtorinë e Spitalit I’hsan Cabej Lushnje, për artikujt objekt prokurimi. Kompania jonë garanton furnizimin me mallrat e kërkuara në rast fitimi të procedurës së prokurimit. Theksojmë se asnjë kompani tjetër, përveç Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS: L42314005A dhe adresë në Rruga At Zef Pellumbi, pallati nr.16, Deivi 2001, Tiranë, nuk është e autorizuar të ofrojë, negociojë apo të firmosë kontratën për mallrat e ofruara në këtë tender.

Pra, referuar autorizimit të prodhuesit “Blerina Sadiku” P.Fizik, në të cilin shprehet që autorizoj kompaninë Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS: L42314005A dhe adresë në Tiranë, që: Të dorëzojë ofertë në emër timin,

Të negociojë, dhe

Të nënshkruajë kontratën në rast fitimi.

Kompania jonë garanton furnizimin me mallrat e kërkuara në rast fitimi të procedurës së prokurimit. Rezulton që kompania “Blerina Sadiku” P.Fizik ka autorizuar kompaninë “Gentian Sadiku” P.Fizik për të dorëzuar ofertë dhe nënshkruar kontratën në rast fitimi të procedurës së cituar të prokurimit në emër të saj, si edhe të ofrojë apo shesë në emër të tij produktet e shoqërisë “Blerina Sadiku” PF në këtë procedurë prokurimi

Per rrjedhojë, konstatoj se kompania jone “Gentian Sadiku” P.Fizik ka arritur të plotësojë pikën 2.3.2 të KVK pasi vërteton origjinën e mallit (prodhuesin), për produktet që ofron. Edhe në këtë pikë, pretendimi i KVO nuk qëndron.

Mirekuptoj ngarkesën e KVO në punën e saj të palodhshme dhe besoj se ky skualifikim i ofertes sone duhet të jetë një lapsus nga ana e tyre që nuk kanë arritur të shohin deri në fund dokumentacionin e paraqitur nga operatori jone ekonomik. Në ankesën tone po bashkangjis dokumentat e pretenduara nga KVO. Si përfundim, kërkoj kualifikimin e ofertes sone si oferte të vlefshme, e cila përmbush plotësisht kërkesat në DT si edhe mbajtjen të skualifikuar të ofertave të OE të tjere pjesëmarrës (Melika Group dhe Amel-E.Z Shpk) të cilët nuk kanë paraqitur: Certifikatën OEKO-TEX, standarti 100, kategoria II (Melika Group SHPK) Kategoria I (Amel-E.Z SHPK).

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3205/1 prot., datë 11.11.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF kundërshton me anë të ankesës me nr. 3205/2025 prot, datë 10.11.2025, si dhe pretendimet për operatorët ekonomik “Melika Group” SHPK dhe “Amel-E.Z” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 3317/9 prot, datë 19.11.2025 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-65818-10-20 me objekt Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje”, dërguar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3205/2 prot datë 19.11.2025 si dhe shkresën nr. 3317/9 prot, datë 19.11.2025 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-65818-10-20 me objekt Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje”, dërguar nëpërmjetë shërbimit postar protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3205/3 prot datë 20.11.2025,

autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 133/2025, datë 18.11.2025 të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë vijon:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njesia e Prokurimit:

Arsyeton:

II.1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës se tij me arsyen se deklarimi nga OE i origjinës së mallit nuk është i vlefshëm, pasi subjekti “Gentian Sadiku” PF nuk është i autorizuar për të ofruar apo shitur produktet e shoqërisë “Blerina Sadiku” PF, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave arsyeton se:

Nepermjet Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara për procedurë të prokurimit me objekt “Blerje material të buta dhe veshmbathje për spitalin rajonal I’hsan Cabej Lushnje”, Autoriteti Kontraktor, OBP SHA në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.2 është përcaktuar se:

“2.3.2 OE ekonomik ofertues do të plotësojë deklaratën mbi origjinën e mallrave objekt prokurimi, për të gjithë artikujt sipas shtojcës 7 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, e cila do të jetë pjesë e zbatimit të kontratës, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Origjina e mallit (prodhuesi)
1.			
2.			
Etj.			

Mbështetur në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të Operatoreve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar LPP-së, Autoriteti Kontraktor, është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Përcaktimi i kriterëve të veçanta për

kualifikim janë lenë nën përgjegjësinë dhe diskrecion të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të natyrës së kontratës, AK përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga Operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Në këtë rast, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë detyrimin të vertetojnë dhe të provojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Ata janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nëse ofertat nuk përgatiten në përputhje me DST, atëherë ato të refuzohen si të papranueshme. KSHA pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga OE ankimues në SPE, konstaton se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), rubrika "A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik, "identifikohet se Operator ekonomik është subjekti "Gentian Sadiku" PF.

Mbështetur në Ekstraktin e Regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit "Gentian Sadiku" PF, gjeneruar në faqen zyrtare të QKB rezultojnë se fusha e veprimtarisë së këtij subjekti ka të bëjë me "Tregtim konfeksione të ndryshme. Import-Export, tregtim të veshmbathjeve dhe materialeve të buta sipas porosive të klientit të natyrës teknike, profesionale, sportive, pune, sanitare-mjekësore, kohë të lire, shkollore, ushtarake, policore, zjarrfikëse, mbrojtëse dhe sigurisë në pune. Tregtim të veglave dhe artikujve sportive, materialeve promovionale, vegla pune të ndryshme dhe elektrike, pjesë këmbimi, materiale ndërtimi pajisje detare hidraulike, materiale pastrimi, kancelari. Tregtim me pakicë të artikujve të ndryshëm".

Për sa më lart, rezultojnë se OE ankimues nuk ka objekt të veprimtarisë prodhimit e veshmbathjeve dhe të materialeve të buta. Ndodhur në këto kushte, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, KSHA konstaton se OE ankimues ka paraqitur Deklaratë origjinale të datës 31.10.2025, nëpërmjet së cilës ka detajuar të gjithë artikujt objekt prokurimi të kërkuara sipas DST, Shtojca 7, si dhe ka përcaktuar origjinin e mallit ku ka deklaruar si prodhues subjektin "Blerina Sadiku" PF. Gjithashtu OE ankimues, ka paraqitur Autorizim prodhuesi ku citohet se: "Subjekti "Blerina Sadiku" PF, autorizon subjektin "Gentian Sadiku" PF që: - të dorëzojë ofertë në emër timin, të negociojë dhe, të nënshkruajë kontratën në rast fitimi, për tenderin me numër referencë REF-65818-10-20-2025, i cili do të zhvillohet më datë 31.10.2025, ora 11:00, pranë AK: Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, me objekt: "Blerje materiale të buta dhe veshmbathje për Drejtorinë e Spitalit 'Ihsan Çabej' Lushnjë". Kompania jone garanton furnizimin me mallrat e kërkuara në rast fitimi të procedurës së prokurimit.

Theksojmë se asnjë kompani tjetër, përveç Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS: L42314005A dhe adresë në Rrugë At Zef Pellumbi, pallati nr. 16, Deivi 2001, Tiranë, nuk është e autorizuar të ofrojë, negociojë apo të firmosë kontratën për mallrat e ofruara në këtë tender". Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi u njoh me përmbajtjen e dokumentit Autorizim Prodhuuesi lëshuar më datë 22.10.2025, gjykon se: Prodhuuesi në rastin konkret ka autorizuar subjektin "Gentian Sadiku" PF në lidhje me dorëzimin e ofertës; negocimin si dhe me nënshkrimin e kontratës në rast të shpalljes fitues. Në analogji me legjislacionin e prokurimit

publik në fuqi, ky autorizim nënkupton shprehjen e vullnetit të prodhuesit në lidhje me perfaqësimin gjatë fazës së dorëzimit të ofertës. Referuar interpretimit gjuhësor të bërë ndaj autorizimit të prodhuesit të paraqitur në SPE, rezulton se subjekti “Blerina Sadiku” PF ka autorizuar subjektin “Gentian Sadiku” PF që të dorëzojë oferte në emër të saj për tenderin objekt ankimimi, çka nënkupton se vullneti i shprehur nga prodhuesi lidhet vetëm me kalimin e të drejtave ekskluzive që kanë të bëjnë me perfaqësimin në një procedurë prokurimi. Në këtë rast, Autorizimi i Prodhuesit, nuk dëshmon dhe nuk identifikon shprehjen e vullnetit të prodhuesit “Blerina Sadiku” PF që do të prodhojë apo do të furnizojë artikujt objekt prokurimi të kërkuara sipas DST (Shtojca 7) në emër dhe për llogari të subjektit “Gentian Sadiku” PF. Sa më lart, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron të papërbushur kërkesën e parashikuar në DST në lidhje me origjinën e mallit (prodhuesin) e deklaruar nga OE ankimues “Gentian Sadiku” PF, si dhe gjykon të saktë e të drejtë vlerësimin e bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Për sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij me arsyen se subjekti “Gentian Sadiku” PF nuk është autorizuar për të ofruar produktet objekti prokurimi, të përdorë Çertifikatën OEKO-TEX dhe Çertifikatën ISO 9001:2015 të shoqërisë “Akrida Tekstil”, KSHA arsyeton se:

Në nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencen ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Ndërkohë në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Në Nenin 21, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, citohet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara

ne këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Në Nenin 79 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozite zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre standardet e kërkuara të cilësisë, vecanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) eficiencës së energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 44, pika 1 parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtesisht dhe në mënyrë të drejtperdrejte me objektin e prokurimit.

Ndërsa në Nenin 92, pika 3 të LPP-së përcaktohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.6, Autoriteti Kontraktor, ka implementuar kërkesat e cilësisë që duhet të plotësojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës duke përcaktuar se: “2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (standarti 100, kategoria I dhe II) ose ekuivalente me to, të vlefshme të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstilë objekt prokurimi, për të vërtetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara

nuk kane substanca të demshme per shendetin dhe janë në perputhje me normativat e specifikuar te çertifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente”.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se në lidhje me përmbushjen e kriterit sipas pikës 2.3.6 të percaktuar në DST, KVK, Kapaciteti teknik, OE ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike (në vijim SPE) dokumentacionin/ Çertifikatat si më poshtë vijon:

- Çertifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria I) lëshuar ne emër të Kompanisë se Tekstileve për Prodhim dhe Tregti të Jashtme AYT Kumascilik, e vlefshme (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar).

- Leje Autorizimi date 12.09.2025 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile AYT Kumascilik autorizon Gentian Sadiku PF te veprojë si perfaqësues zyrtar dhe furnizues i autorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë (e perkthyer në gjuhen shqipe dhe e noterizuar). Nëpërmjet kësaj Leje Autorizimi, Kompania e tekstileve AYT Kumascilik autorizon subjektin Gentian Sadiku PF te veprojë si perfaqesues zyrtar dhe furnizues i autorizuar në territorin e Republikës së Shqiperisë ku:

- OE ankimues ka tagrin për të paraqitur dhe shitur produktet tekstile te AYT Kumascilik
- OE ankimues ka te drejte të marrë pjese ne procedurat e prokurimit publik dhe privat duke ofruar produktet e AYT Kumacilik,

- OE ankimues gezon te drejten e perdorimit te Certifikatave ndërkombëtare në emër të kompanisë AYT Kumacilik dhe konkretisht: OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria I; ISO 9001:2015 si dhe ISO 14001:2015.

- Deklaratë origjine date 31.10.2025, nëpërmjet se ciles OE ankimues ka detajuar te gjithë artikujt objekt prokurimi të kerkuar sipas DST, Shtojca 7, si dhe ka përcaktuar origjinën e mallit ku si prodhues ka deklaruar subjektin “Blerina Sadiku” PF;

- Çertifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria II) lëshuar ne emër të Kompanisë AKRIDA TEKSTIL, e vlefshme (e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar);

- Leje Autorizimi date 21.02.2023 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile Akrida Tekstil autorizon subjektin Blerina Sadiku PF të ofrojë produktet e Akrida Tekstil si dhe të përdorë Çertifikatën OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria II) dhe Çertifikatën ISO 9001:2015 (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar);

- Leje Autorizimi datë 12.09.2025 nëpërmjet së cilës Kompania tekstile AYT Kumascilik autorizon Blerina Sadiku PF të veprojë si përfaqësues zyrtar dhe furnizues i autorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë ku:

- OE ankimues ka tagrin për të paraqitur dhe shitur produktet tekstile të AYT Kumacilik,

- OE ankimues ka të drejtë të marrë pjesë në procedura të prokurimeve publike dhe private duke ofruar produktet e AYT Kumacilik,

- OE ankimues gezon të drejtën e përdorimit të Çertifikatave ndërkombëtare në emër të kompanisë AYT Kumacilik dhe konkretisht: OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria I); ISO 9001:2015 si dhe ISO 14001:2015.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se shqyrtimi i përmbushjes së këtij kriteri lidhet ngushtësisht me dokumentin Autorizim Prodhuesi paraqitur në SPE nga OE ankimues. Ndodhur në kushtet ku pretendimi i OE ankimues në lidhje me Autorizimin e Prodhuesit nuk qëndron, rrjedhimisht dhe llogjikisht çdo dokument i cili është në emër dhe për llogari të Prodhuesit të deklaruar nuk mund të merret në konsideratë, pasi shqyrtimi tij bëhet në analogji të plotë me dokumentin Autorizim Prodhuesi. Për sa më lart, OE ankimues nuk është i autorizuar nga subjekti “Blerina Sadiku” PF në lidhje me furnizimin e artikujve të parashikuar në DST, automatikisht ai nuk ka të drejtë dhe tagër që të përdorë dokumentet e lëshuara në emër të saj.

Në përfundim, KSHA gjykon se OE ankimues nuk plotëson kërkesën e cilesisë të përcaktuar sipas DST, KVK, Kapaciteti teknik, pika 2.3.6 (në lidhje me disponimin e Çertifikates OEKO-TEX (standarti 100, kategoria I dhe II) ose ekuivalente me to, të vlefshme.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për Këto Arsye

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenin 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

Vendosi

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomike të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qendror Blerës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 Për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Gentian Sadiku*” PF, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “*Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të seksionit 2.3 Kapacitetit Teknik, pasi në Çertifikatën OEKO-TEX standarti 100 kategoria II, shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin nr. rep. 1403 dt. 05.02.2025, konstatohet se kompania prodhuese e lëndës së parë “Akrida Tekstil” ka autorizuar subjektin “Blerina Sadiku” për të ofruar produktet e e saja dhe të përdorë çertifikatën OEKO-TEX, çertifikatën ISO 9001:20215 në prokurimet publike. Nga sa më sipër rezulton subjekti “Gentian Sadiku” nuk është i autorizuar për të ofruar produktet, të përdorë çertifikatën OEKO-TEX dhe çertifikatën ISO 9001:20215 të shoqërisë “Akrida Tekstil”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.6 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (standarti 100, kategoria I dhe II) ose ekuivalente me to, të vlefshme të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstile objekt prokurimi, për të vërtetuar se lënda e parë e artikujve të ofruara nuk kane substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të çertifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “*Gentian Sadiku*” PF ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Çertifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria I) lëshuar në emër të Kompanisë së Tekstileve për Prodhim dhe Tregti të Jashtme AYT Kumascilik, e vlefshme (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar).
- Leje Autorizimi date 12.09.2025 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile AYT Kumascilik autorizon Gentian Sadiku PF të veprojë si përfaqësues zyrtar dhe furnizues i autorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar) me të drejtën për të:
 - Prezantuar dhe shitur produktet tona tekstile;
 - Marrë pjesë në procedura prokurimi publike dhe private duke ofruar produktet tona;
 - Përdor, në emër të kompanisë sonë, certifikatat ndërkombëtare të vlefshme që zotërojmë, përfshirë:
 - OEKO – TEX Standart 100
 - ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë).
 - ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor).

- Certifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria II) lëshuar ne emër të Kompanisë AKRIDA TEKSTIL, e vlefshme (e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar);

- Leje Autorizimi date 06.02.2023 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile Akrida Tekstil autorizon kompaninë Gentian Sadiku PF me NUIS L42314005A për të ofruar produktet tona, dhe për të përdorur certifikatën OEKO – TEX, certifikatën ISO 9001:2015, në procedurat e prokurimit. Ne do furnizojmë kompaninë e sipërpërmendur në rast se fiton këtë procedurë.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi

të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të

papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i

shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim. Në rastin konkret lidhur me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatohet se referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF janë dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentet **1-** Çertifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria I) lëshuar në emër të Kompanisë së Tekstileve për Prodhim dhe Tregti të Jashtme AYT Kumascilik, e vlefshme (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar). **2-** Leje Autorizimi date 12.09.2025 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile AYT Kumascilik autorizon Gentian Sadiku PF të veprojë si përfaqësues zyrtar dhe furnizues i autorizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar) me të drejtën për të: - Prezantuar dhe shitur produktet tona tekstile; - Marrë pjesë në procedura prokurimi publike dhe private duke ofruar produktet tona; - Përdor, në emër të kompanisë sonë, certifikatat ndërkombëtare të vlefshme që zotërojmë, përfshirë: - OEKO – TEX Standart 100; - ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë); - ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor). **3-** Çertifikatë OEKO-TEX Standart 100 (Kategoria II) lëshuar në emër të Kompanisë AKRIDA TEKSTIL, e vlefshme (e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar); **4-** Leje Autorizimi date 06.02.2023 nëpërmjet se ciles Kompania tekstile Akrida Tekstil autorizon kompaninë Gentian Sadiku PF me NUIS L42314005A për të ofruar produktet tona, dhe për të përdorur certifikatën OEKO – TEX, certifikatën ISO 9001:2015, në procedurat e prokurimit. Ne do furnizojmë kompaninë e sipërpërmendur në rast se fiton këtë procedurë. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik.

Përsa më sipër Komisioni Prokurimit Publik e gjen arsyen e skualifikimit të ankimuesit të pabazuar. Komisioni i Prokurimit Publik, i është referuar edhe jurisprundencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila në çështje të ngjashme (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëllë për të gjithë ofertuesit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe

parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, K.P.P. gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Në respektim të nenit 3 të LPP, nuk mund të lejohet skualifikimi i një operatori ekonomik, në rast se ai nuk ka mungesë dokumentacioni dhe ka plotësuar kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor me anë të dokumentacionit të dorëzuar.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “*1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi*”. Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e automjeteve të kërkuar në dokumentat e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF për përmbushjen e kriterit 2.3.6 konsiderohet i rregullt, duke plotësuar kështu këtë kriter të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “Për më tepër, shoqëria pjesëmarrëse në procedurë “Gentian Sadiku” PF me NUIS L42314005A ka deklaruar si prodhues shoqërinë “Blerina Sadiku” P.Fizik, si dhe ka paraqitur autorizim prodhuesi nga kjo shoqëri. Referuar autorizimit të prodhuesit të paraqitur rezulton se shoqëria “Blerina Sadiku”

P.Fizik ka autorizuar kompaninë Gentian Sadiku P.Fizik, me NUIS, L42314005A dhe adresë në Tiranë, që: • të dorëzojë ofertë në emër timin; • të negociojë, dhe • të nënshkruajë kontratën në rast fitimi, për tenderin me numër reference REF-65818-10-20-2025, i cili do të zhvillohet më datë 31.10.2025, ora 11:00, pranë AK: Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, me objekt: “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje për Drejtorinë e Spitalit ‘Ihsan Çabej’ Lushnje”. Referuar këtij autorizimi rezulton se shoqëria “Blerina Sadiku” PF ka caktuar shoqërinë “Gentian Sadiku” PF si përfaqësues i saj në këtë procedurë prokurimi për të dorëzuar ofertë dhe nënshkruar kontratën në rast fitimi të procedurës së cituar të prokurimit në emër të saj, por jo të ofrojë apo shesë në emër të tij produktet e shoqërisë “Blerina Sadiku” PF në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim deklarimi nga OE i origjinës së mallit nuk është i vlefshëm. Nga sa më lart OE “Gentian Sadiku” PF nuk plotëson pikën 2.3.2 të KVK pasi nuk vërteton origjinën e mallit (prodhuesin), për produktet që ofron”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2 OE ekonomik ofertues do të plotësojë deklaratën mbi origjinën e mallrave objekt prokurimi, për të gjithë artikujt sipas shtojcës 7 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, e cila do të jetë pjesë e zbatimit të kontratës, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Origjina e mallit (prodhuesi)
1.			
2.			
Etj.			

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë origjine e datës 31.10.2025, nëpërmjet së cilës operatori ekonomik ankimues ka detajuar të gjithë artikujt objekt prokurimi të kërkuar sipas DST, konkretisht shtojcës 7, duke përcaktuar origjinën e mallit (Prodhuesi) ku si prodhues ka deklaruar subjektin “Blerina Sadiku” PF me NIPT K97730102T, Tiranë, Shqipëri.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 e VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm

ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.8. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.2. *OE ekonomik ofertues do të plotësoje deklaratën mbi origjinën e mallrave objekt prokurimi, për të gjithë artikujt sipas shtojcës 7 "Sasia dhe grafiku i lëvrimit", e cila do të jetë pjesë e zbatimit të kontratës, sipas tabelës.* Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se, operatorët ekonomikë ofertues plotësoje deklaratën mbi origjinën e mallrave objekt prokurimi. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se, vetë operatori ekonomik ankimues ka bërë një deklaratë ku ka deklaruar prodhuesin e artikujve objekt prokurimi sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Referur arsyes së skualifikimit, të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit të ngakuar në SPE në përmbushje të këtij kriteri, KPP konsaton se, nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, pra Deklaratë Origjine i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues përmbushet kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2. Pra, arsyeia e skualifikimit e dhënë nga autoriteti kontraktor, nuk qëndron. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të mësipërm pika 2.3.2, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Gjithashtu sa i përket pretendimit të autorizimit të prodhuesit të ngritur nga ana e autoritetit kontraktor. Rezulton se në nenin 92 pika 4, të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji"*. Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ quazi gjyqësor dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 92 pika 4 e LPP-së, i cili parashikon se *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji"*, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar dokumenteve të

procedurës së prokurimit, kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë pikë të kriterëve të veçanta të kualifikimit se operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim distributori. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi kriterë të pakërkua dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit të tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. KPP gjykon se në cilësinë e një organi quazi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës Judicis est judicare secundum allegata et probate (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces) . KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi kriterë të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e garës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF mbi shoqërinë “Melika Group” SHPK dhe “Amel – E.Z” SHPK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 05.11.2025, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezultojnë që këto operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF mbi shoqërinë “Melika Group” SHPK dhe “Amel – E.Z” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-65818-10-20-2025, me objekt “Blerje materiale të buta dhe veshmbathje” për Drejtorinë e Spitalit I’hsan Çabej Lushnje” me fond limit: 3,166,588 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë)0 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF në baze të konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e kualifikuar këtë operat ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

